

URDHËR
Nr. 633, datë 17.11.2020

PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA

(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 9.3.2021; me urdhrin nr. 158, datë 11.3.2021; nr. 183, datë 26.3.2021; nr. 183/1, datë 8.4.2021, nr. 183/2, datë 22.4.2021; nr. 183/3, datë 5.5.2021; nr. 183/4, datë 20.5.2021; nr. 183/5, datë 14.6.2021; nr. 183/6, datë 28.6.2021; nr. 327, datë 12.7.2021; nr. 349, datë 26.7.2021; nr. 349/1, datë 6.8.2021; nr. 375, datë 30.8.2021; nr. 375/1, datë 20.9.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si edhe vendimit të Komitetit Teknik nr. 4156/1, datë 16.11.2020,

URDHËROJ:

1. Ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore deri në datën 4.10.2021.

1/1. Ndalohen grumbullimet me më shumë se 50 persona në vende të hapura, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore nga data 15.6.2021 deri në datën 28.6.2021. Grumbullimet sipas kësaj pike të respektojnë masat e distancimit social dhe protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

1/2. Lejohen konferencat me kapacitet të reduktuar deri në 30% të pjesëmarrësve dhe në zbatim të protokollit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik nga datë 1.7.2021.

2. Pika 4 e urdhrit nr. 351, datë 29.5.2020 “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu